

DOKUMENTI KONSULTATIV

Për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në kuadër të procesit të konsultimit të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” mirëpret sugjerimet nga qytetarët, ekspertë të fushës, nga të gjitha institucionet dhe subjektet e interesuara, organizata jofitimprurëse, shoqëria civile, të drejtat ose objekti i veprimtarisë të cilave ka të bëjë apo ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo nga përcaktimet e kësaj nisme.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimet në portalin e Regjistrat Elektronik: 20 ditë pune, duke filluar nga data 6.12.2024 deri më

Si të përgjigjeni:

Kontributet që në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, do të përcillen nga institucionet e interesuara në adresën postare të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në adresën; Rruga “Dëshmorët e 4 Shkurtit”, Tiranë, në adresën e e-mailit të koordinatorit për konsultimin publik eriola.kocileri@meki.gov.al.

Kontakti:

Eriola Koçileri, Koordinatore për konsultimin publik në Ministri: eriola.kocileri@meki.gov.al

Datat dhe vendet e takimeve publike:

E-Konsultimi: në portalin “Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike” 20 ditë pune, duke filluar nga data 6 dhjetor 2024.

Sfondi i propozimit legjislativ

Nevoja për të rishikuar kuadrin ligjor aktual të konkurrencës vjen nga praktika e Autoritetit të Konkurrencës, i cili duke mbajtur në konsideratë praktikën më të mira të institucioneve homologe në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, ka luajtur ndër vite një rol kyç në mbikëqyrjen dhe promovimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në të gjitha sektorët e ekonomisë në Shqipëri. Është e nevojshme për të garantuar një rregullim ligjor më të qendrueshëm dhe efektiv, duke kontribuar në zhvillimin e një tregu më të hapur dhe më konkurrues, që ligji “Për mbrojtjen e konkurrencës” të reflektojë këtë përvojë të arritur.

Në këtë kontekst, mbrojtja e konkurrencës, për vetë rëndësinë që mbart në Bashkimin Evropian dhe në kuadër të procesit të integritetit ku Autoriteti i Konkurrencës është lider i Kapitullit 8 “Politika e konkurrencës”, si dhe të përmirësimit të mekanizmave ligjorë ekzistues, në respekt të përvojës shumëvjeçare të Autoritetit, është hartuar projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e

konkurrencës””, qëllimi i të cilit është të përmirësojë rregullat për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në tregun e brendshëm për të nxitur eficientë ekonomike.

Propozimet

Objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektligji janë :

Harmonizimi i mëtejshëm me acquis të BE dhe përputhja me standardet e saj për mbrojtjen e konkurrencës, duke reflektuar sfidat bashkëkohore dhe zhvillimet e reja në këtë fushë;

Garantimi i lirisë së veprimtarisë ekonomike për subjektet që operojnë në tregun e brendshëm;

Rritja e efektivitetit të mbrojtjes së konkurrencës nëpërmjet forcimit të rolit të AK në cilësinë e organit përgjegjës për garantimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg;

Sigurimi i mbikëqyrjes më efektive të zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e konkurrencës nëpërmjet ndërveprimit me bazat e të dhënave të insitucioneve ligjzbatuese;

Përmirësimi i trajtimit të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së sekreteve tregtare lidhur me ndërmarrjet që ndjekin procedura në bazë të kuadrit ligjor të mbrojtjes së konkurrencës;

Krijimi i një kuadri ligjor gjithëpërfshirës e e të përditësuar, duke përfshirë në kompetencat e AK trajtimin e “marrëveshjeve në oferta” në procedurat e prokurimit publik, “killer acquisitions” dhe “ftesë për marrëveshje të ndaluar”, në reflektim të praktikave më të mira të vendeve të BE-së.

Implementimi i institutit të parashkrimit të ndëshkimit administrativ, sipas praktikave më të mira të BE.

Pyetjet

Reagimet që priten janë të hapura dhe nuk parashikohet ngritja e pyetjeve specifike, të cilat kërkojnë përgjigje. Pyetje të mundshme mund të jenë: A pajtoheni me qartësinë e parashikimeve në projektligj dhe çfarë do të propozoni shtesë për të përmirësuar cilësinë e tij? Si i vlerësoni përcaktimet në projektligj, mbi: Rritjen e efektivitetit të mbrojtjes së konkurrencës nëpërmjet forcimit të rolit të AK në cilësinë e organit përgjegjës për garantimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg?